



“Radstock Albania” ka privilegjin dhe gëzimin e madh të mirëpresë në hapjen e Akademisë Radstock: “Trajnimin intensiv për Kishëmbjellës”.

Trajnimi kombinon principet biblike me mësim nga jeta e përditshme reale të sjella nën dritën e përvojës së kishëmbjellësve ndërkombëtarë. Gjithashtu do t’i jepet përparësi fokusimit individual duke vendosur theksin në parashtrimin e ndihmesës ndaj gjithësecilit, që çdokush të kuptojë e të analizojë oportunitetet, fuqitë, dobësitë si dhe cilësinë e të qëndruarit në përshtatshmëri me shërbesën e kishëmbjelljes.

Mësimdhënia do të jepet nga kishëmbjellës me përvojë nga Shqipëria, Ukraina, Britania e Madhe dhe SHBA.

Një theks i rëndësishëm do i vendoset kohës së diskutimit dhe miqësisë me instruktorët në mënyrë që të marrin e përvetësojnë edhe nga përvoja e tyre.

Trajnimi është i hapur për njerëz nga çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë. Janë të detyrueshme dhe të nevojshme si kërkesa zyrtare (aplikimi) ashtu dhe një rekomandim nga kisha lokale. Deri më tani, janë rregjistruar gjashtë aplikantë nga Shqipëria dhe Ukraina. Regjistrimi do jetë i limituar në 10 vende.

Trajnim nga “Akademia Radstock”

Data e zhvillimit të Kursit:

15 Maj 2017 – 09 Qershor 2017

Vendi: Durrës, Shqipëri

Kosto trajnimit: € 850.00

- përfshin akomodim
- ushqim,
- materiale mësimore

(Kjo është kosto reale. Për suport financiar apo detaje shiko bashkëngjitur formularin e aplikimit)

Për më shumë informacion dhe për Formularin e Aplikimit kontakto:

Brian Jose brian@radstock.org

Mob. ++355 069 261 2477